



**Project Code:** 2024-1-IT02-KA220-HED-000249904



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.




## CULTURE & TECHNOLOGY

Projekti CULT integron njohuritë teknologjike dhe artistiko-kulturore duke adoptuar një qasje STEAM brenda institucioneve të arsimit të lartë evropian të natyrës tekniko-teknologjike.

Kjo nismë i përgjigjet përhapjes gjithnjë e më të madhe të teknologjive digjitale në vlerësimin dhe përdorimin e pasurive kulturore dhe synon të lehtësojë aksesin e grave me formim në shkencë humane drejt fushave të studimit STEM.

Dhe pikërisht këtu hyn në lojë Projekti “CULT – Kultura & Teknologjia”, me kodin 2024-1-IT02-KA220-HED-000249904!

CULT është një projekt dyvjeçar, bashkëfinancuar nga Programi Erasmus+ i Komisionit Evropian, dhe zbatohet nga një konsorcium prej 8 partnerësh nga 5 shtete të BE-së.




# OBJEKTIVAT KRYESORE

- Shtjellimi i dizajnit mikro të KURRIKULËS HE STEAM
- Shtjellimi i makro-dizajnit të KURRIKULËS HE STEAM
- Aktivizimi i sinergjive operative ndërmjet poleve akademike dhe organizatave kulturore



# PARTNERITETI

8 partnerët nga 5 vende të BE-së përfaqësojnë rrjete ndërkombëtare institucionale, akademike, të trajnimeve, konsulencës dhe kërkimit shkencor.



## PARTNERITETI

**Universiteti i Camerino-s (UniCam) me qendër në Camerino (Rajoni Marche, Itali),** ka qenë universitet publik që nga viti 1958, por është themeluar në vitin 1336.

UniCam ka rrënjë në të kaluarën, por rritet dhe përmirësohet duke parë nga e ardhmja. Për 21 vite me radhë, UniCam është renditur në vend të parë ndër universitetet e vogla (deri në 10,000 studentë të regjistruar) dhe aktualisht ka pesë shkolla universitare të shpërndara në katër kampuse. Në zonën e Camerino-s ndodhen Shkollat e Shkencave Farmaceutike dhe Produkteve të Shëndetit, Juridiku, Shkenca dhe Teknologjia; ndërsa në bashkitë Matelica dhe Ascoli Piceno ndodhen respektivisht Shkolla e Shkencave Mjekësore Veterinare dhe ajo e Arkitekturës dhe Dizajnit.

Shkolla e Shkencës dhe Teknologjisë karakterizohet nga një shkallë e lartë ndërdisiplinariteti mes shkencave, gjë që lehtëson bashkimin e kompetencave në tema të ndryshme kërkimi.

Spektori i Shkencave Kompjuterike në Universitetin e Camerino-s është në pararojë të kërkimit dhe edukimit në disiplina kyçe si sistemet e informacionit të biznesit, inteligjenca artificiale, zhvillimi i softuerit dhe teknologjitë me fokus analizimin e të dhënave, process mining (analizimi i proceseve përmes të dhënave), automatizimin e proceseve të biznesit dhe blockchain.



## PARTNERITETI


**CONFORM S.c.a.r.l.** operon që nga viti 1995 në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar projekte kërkimore, plane trajnimi në formate fizike, me përvojë praktike dhe e-learning, aktivitete konsulence për biznese dhe administratën publike, hartimin e planeve të komunikimit tradicional dhe me mediat e reja, prodhime audiovizuale dhe filmike, realizimin e zgjidhjeve dhe lojërave VR, AR dhe MR, zhvillimin e strategjive të gamifikimit dhe marketingut të bazuar në lojëra, me mbështetjen e stafit ekspert dhe të një ekipi trajnerësh, konsulentësh dhe menaxherësh me eksperiencë të suksesshme, si dhe një rrjeti të gjerë partnerësh me mbi 250 organizata kombëtare, evropiane dhe partnerë ndërkombëtarë.



## PARTNERITETI

**Universiteti i Tiranës (UT)**, i themeluar në vitin 1957, është universiteti më i madh dhe më prestigjioz publik në Shqipëri. UT përbëhet nga gjashtë fakultete dhe dy institute, dhe ofron 174 programe në të tre ciklet e studimit, me staf akademik prej 779 vetash me kohë të plotë dhe rreth 28,550 studentë. Falë traditës, nivelit të lartë të kualifikimit, trajnimit dhe çertifikimit, Universiteti i Tiranës mbetet universiteti më i kërkuar në vend. Institucioni është i njohur për traditën akademike, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe kontributet në shkencë, kulturë dhe zhvillim ekonomik. Aktualisht, Universiteti i Tiranës është universiteti më i madh në vend.

UT merr pjesë në mënyrë aktive në programe bashkëpunimi evropian si Erasmus+, Tempus dhe Horizon Europe, duke nxitur shkëmbimet akademike dhe bashkëpunime kërkimore me universitete nga e gjithë bota. Gjithashtu është pjesë e rrjeteve ndërkombëtare si AUF, UNICA dhe UNIMED, duke forcuar rolin e tij si institucion udhëheqës në rajonin e Ballkanit Perëndimor.




## PARTNERITETI

**Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)** është një “think tank” me qendër në Tiranë që kontribuon në demokratizim, zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik në Shqipëri dhe rajon, në bashkëpunim me partnerë nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian. SCiDEV angazhohet kryesisht në kërkime që ndikojnë politikat dhe veprimet, kryen studime që informojnë proceset vendimmarrëse, ndikojnë zhvillimin e politikave dhe udhëheqin përpjekjet për avokim, ndërtim kapacitetesh, mentorim, komunikim shkencor dhe angazhim me aktorë në Heliksin e Katërfishtë.


Veprimtaria e SCiDEV është e organizuar në katër shtylla kryesore:

- Demokraci dhe Qeverisje – kontribuon në ndërtimin e institucioneve demokratike, integrimin evropian, sundimin e ligjit dhe pjesëmarrjen publike përmes kërkimit, dialogut përfshirës në politikë-bërje, angazhimit me aktorët dhe nismave për transparencë dhe llogaridhënie.




# PARTNERITETI

- Media dhe Komunikim - promovon lirinë e shprehjes, zhvillimin e medias, sigurinë e gazetarëve, edukimin mediatik dhe informativ dhe mbështet vetërregullimin dhe vetëorganizimin në sektorin e medias.
- Fuqizimi i lidhjes midis Kërkimit dhe Shoqërisë - ndërton ura ndërmjet akademisë dhe shoqërisë duke përparuar transferimin e dijes, angazhimin e diasporës dhe ndërkombëtarizimin e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe duke mbështetur kërkimin, inovacionin dhe fuqizimin e të rinjve dhe komuniteteve.



## PARTNERITETI

**Universiteti i Zagrebit** është institucioni kryesor arsimor në Kroaci me 31 fakultete, 3 akademi arti dhe qendra e departamente universitare të ndryshme. Si universitet publik dhe gjithëpërfshirës në Evropën Qendrore, UNIZG ofron programe në të gjitha fushat shkencore (artet, biomjekësia, bioteknologjia, inxhinieria, shkencat humane, shkencat natyrore dhe shkencat sociale) dhe një gamë të gjerë kursesh në të gjitha nivelet e studimit, nga universitare në pasuniversitare për më shumë se 70,000 studentë. Universiteti dallon jo vetëm për mësimdhënie, por edhe për kërkimin shkencor, duke kontribuar me mbi 50 përqind të prodhimit vjetor të kërkimit në Kroaci.




## PARTNERITETI

**Universiteti Côte d'Azur** është një universitet kërkimor intensiv, që mbështetet te një ekosistem i fortë institucionesh universitare dhe kërkimore (Observatori i Côte d'Azur, CNRS, INRIA, etj.), që:

- Mirëpret mbi 30,000 studentë
- Punëson mbi 4,000 persona të përfshirë në kërkim në laboratorë të vlerësuar me A ose A+
- Ka 493 partneritete aktive për kërkim dhe trajnim
- Ka përvojë të fortë në menaxhimin e projekteve evropiane (mbi 100) dhe atyre kombëtare
- Ka fituar 76 çmime kombëtare dhe 48 ndërkombëtare në kërkim
- Ka 113 patenta aktive dhe 37 licenca

Gjatë viteve të fundit, Universiteti Côte d'Azur ka transformuar strukturën e tij në një organizatë më dinamike dhe fleksibël për t'iu përshtatur nevojave të shoqërisë dhe për të përgatitur më mirë akademikët dhe profesionistët e rinj për një botë në ndryshim e sipër. Modeli aktual i Universitetit Côte d'Azur mbështetet në bashkëpunim transdisiplinor, një model eksperimental koordinimi ndërmjet kërkimit, trajnimit dhe inovacionit, si dhe partneritete të qëndrueshme me subjektet e sektorit privat dhe politikbërësit lokalë.



## PARTNERITETI

**Culturalink** është një kompani konsulence e specializuar në kërkim, analizë, këshillim dhe planifikim strategjik në sektorët kulturorë dhe kreativë, me një histori të fortë prej mbi 100 projektsh në rajonet spanjolle. E themeluar në vitin 2001, C>LINK mban lidhje të forta me komunitetet kulturore dhe artistike lokale, veçanërisht në Canarias (selia qendrore) dhe València.

C>LINK merr pjesë në projekte të financuara nga BE, veçanërisht në programin Horizon, duke realizuar kërkime, zbatuar pilotime dhe vlerësime të detyrave. Si një entitet i lidhur me ekosistemin kërkimor, C>LINK bashkëpunon me Universitetin e Valencia-s përmes zyrës së saj në Parkun e Shkencës dhe Teknologjisë të Universitetit.

Përveç konsulencës së aplikuar kulturore, C>LINK ka zgjeruar fushën e saj të punës edhe në fusha të tjera aktiviteti, ku kultura ka lidhje ndërsektoriale. Si rrjedhojë, një numër i madh projektsh janë realizuar në lidhje me planifikimin ekonomik, ekonominë dixhitale, zhvillimin urban, politikat e barazisë gjinore, turizmin, arsimin, politikat sociale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.



## PARTNERITETI

**Universiteti i Valencias (Universitat de València, UV)** është një nga institucionet më të vjetra akademike në Spanjë, me rrënjë që datojnë në vitin 1499. Përgjatë shekujve, është zhvilluar dhe zgjeruar vazhdimisht duke ruajtur angazhimin e tij ndaj kërkimit, mësimdhënies cilësore dhe përfshirjes sociale. Ofertat e tij akademike variojnë nga fushat më tradicionale të studimit deri te fushat më të fundit në zhvillim, duke theksuar një karakter të fortë multidisiplinar dhe inovativ. Sot UV-ja përfshin një gamë të gjerë fakultetesh dhe shkollash që mbulojnë disiplina të ndryshme si shkencat shëndetësore, shkencat humane, shkencat sociale, inxhinieria dhe shkencat eksperimentale.



# REZULTATET

## KURRIKULA HE STEAM

Hibridizimi i Kulturës dhe Teknologjisë

## 8 PAKETA MIKRO-MËSIMI

Do mundësojnë mësim të përzgjedhur, të rastësishëm, në kohë reale dhe të personalizuar

## 1 SKENAR I GAMEFIKUAR

Do u mundësojë përdoruesve të bëjnë zgjedhje që ndikojnë në rrjedhën e tregimit

## 1 LËVIZSHMËRI NDËRKOMBËTARE

Përfshirja e ligjëruesve të BE-së mbi metodat e mentorimit të frymëzuara nga arti





**Project Code:** 2024-1-IT02-KA220-HED-000249904



**Co-funded by  
the European Union**

Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

